



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

2

Nr. 426 Prot.

Tiranë, më 19.04.2016

VENDIM Nr. 20, datë 13.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi gjetjet e konstatuara gjatë punës për restaurimin e "Tyrbes së Kapllan Pashës", Tiranë*, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin mbi gjetjet e konstatuara gjatë punës për restaurimin e "Tyrbes së Kapllan Pashës", Tiranë*, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Të kryhet nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k., gërmimi arkeologjik i shpëtimit për sipërfaqen përreth monumentit, me qëllim sqarimin e situatës dhe dokumentimin e strukturave të evidentuara gjatë punimeve restauruese. Raporti i rezultateve të gërmimit arkeologjik të paraqitet në KKA e radhës.
3. Të realizohet mbikëqyrja e punimeve të gërmimit arkeologjik të shpëtimit nga Instituti i Arkeologjisë, në bashkëpunim me ASHA.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)